

BAZA LIGJORE E TRAJTIMIT TE
PRONAREVE PER LIRIM BANESE DHE
QIRAMARRESVE NE ISH PRONE PRIVATE
PER TRAJTIM ME KREDI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

K

AKT NORMATIV

Nr. 3, datë 1.3.2012

PËR

LIRIMIN E BANESAVE PRONARËVE TË LIGJSHËM NGA QYTETARËT E PASTREHË, BANUES NË BANESAT ISH - PRONË E SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Neni 1

Lirimin dhe dorëzimin e banesës nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, emrat e të cilëve janë dërguar nga Enti Kombëtar i Banesave në Bankën Kombëtare Tregtare, në vijim referuar BKT, për kreditim, në kushtet deri 30 vjet afat, me 0 (zero) % interes vjetor, sipas programit social të trajtimit me kredi të lehtësuar nga shteti, në zbatim të udhëzimit nr.6257, datë 2.9.2008, "Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti", të ministrit të Financave dhe ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të ndryshuar, apo që duhet të aplikojnë për këtë projekt strehimi, brenda datës 1 nëntor 2012.

Neni 2

Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të dorëzojë në BKT, deri më 5 shtator 2012, listën e qytetarëve të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar, që kanë aplikuar apo nuk kanë aplikuar ende në Entin

Kombëtar të Banesave, me gjithë njoftimin publik të bërë më 4.11.2009. Lista publikohet e plotë edhe në faqen zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave, brenda datës 5 shtator 2012.

Neni 3

Kur lirimi dhe dorëzimi i banesës sipas nenit 1, të këtij akti normativ, nuk ndodh brenda datës 1 nëntor 2012, pronari i pronës ose një përfaqësues ligjor i ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm i dërgon Entit Kombëtar të Banesave njoftimin respektiv. *"Tip" Certificate provise, karta e frekshat,*

Enti Kombëtar i Banesave, brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e njoftimit me shkrim, konfirmon, me shkrim, se qytetari/ët i/e pastrehë është/janë në listën e botuar për trajtim me kredi me 0 (zero) % interes në vit, për një afat kohor deri në 30 vjet, një afat kohor deri

Ky konfirmim, në kuptim të këtij akti normativ, përbën titull ekzekutiv sipas nenit 510, shkronja "e", të Kodit të Procedures Civile, dhe Enti Kombëtar i Banesave, brenda 1 (një) ditë pune, regjistron kërkesën për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, në gjykatën ku ndodhet pasuria e paluajtshme, në favor të kreditorit.

E gjithë procedura e lëshimit të urdhrin të ekzekutimit, në gjykatë, në emër të kreditorit, kryhet nga punonjës të Entit Kombëtar të Banesave dhe informacioni publikohet në faqen zyrtare të këtij enti.

Enti Kombëtar i Banesave i dorëzon me procesverbal me shkrim, pronarit të tokës apo përfaqësuesit ligjor të ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm, urdhrin e ekzekutimit.

Pronari i pronës ose një përfaqësues i ngarkuar prej tij me autorizim të posaçëm ka të drejtë t'i drejtohet shërbimit përmbartimor gjyqësor, pas lëshimit të urdhrin të ekzekutimit nga gjykatë, që të bëjë lirimin e banesës. Gjykatat e shkallës së parë nuk mund të kryejnë pezullimin e këtij urdhri ekzekutimi.

Neni 4

Për çdo qytetar të pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të bashpronësuar, që nuk liron banesat, ndonëse janë në listat e dërguara nga Enti Kombëtar i Banesave në bankën BKT-së për kreditim, në kushtet deri 30 vjet të kreditimit me 0 (zero) % interes vjetor, pas ekzekutimit të titulli ekzekutiv, sipas nenit 4, veçohet si më poshtë vijon:

- Trajtohen me strehim në banesa sociale nga këshillat bashkiakë, duke pasur përparësi në programet e banesave sociale për qira. Këshillat bashkiakë të bashkive përkatëse, brenda datës 15 nëntor 2012, ftohen të planifikojnë numrin e banesave kur objektet janë me fonde të tyre. Për financime me fonde të pushtetit qendror, këshillat bashkiakë duhet të shpërndajnë të paktën ½ e kuotës për këtë kontingjent:

- Për persona të moshuar, të paafatë të kujdesen dhe pa persona të tjerë në ngarkim, kur nuk dëshirojnë, me deklaram me shkrim, sistemim me qira apo, sipas verifikimit të kryer, janë të paafatë të kujdesen për vete, bëhet sistemimi me strehimin e tyre në qendrat e përkujdesjes për moshat e treta.

Neni 5

Fondet e parashikuara për kredi për të pastrehët në familje me ish-pronarë, i rialokohen buxheteve vendore, njësitë e të cilave kanë sistemuar qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara brenda tremujorit të parë të vitit 2013, për programin strehim.

Neni 6

Ftohen ish-pronarët apo përfaqësuesit ligjorë të tyre, që kanë të dhëna se qytetarët e pastrehë që mbajnë pronat e tyre disponojnë pasuri të luajtshme ose paluajtshme në të njëjtin rreth apo kanë të dhëna se nuk banojnë më në mjediset e tyre apo i mbajnë të mbyllura, t'ia vënë në dispozicion Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim verifikimin e të dhënave që disponojnë ata nga deklaruësit. Enti Kombëtar i Banesave nis menjëherë verifikimin, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse. Brenda 20 (njëzetë) ditëve pune Enti Kombëtar i Banesave përfundon verifikimin. Të gjithë autoritetet publike dhe shtetërore detyrohen t'i kthejnë përgjigje një kërkesë të Entit për verifikim, në kuptim të këtij neni, brenda 2 (dy) ditëve pune. Në përfundim të verifikimit Enti Kombëtar i Banesave vendos:

- të përfundojë shqyrtimin pasi të dhënat janë të paplota ose të rreme; të bëjë kallëzim penal pasi subjekti i pastrehë ka deklaruar të dhëna të rreme, përdor në mënyrë të paligjshme këtë pronë pasi është pronar, disponon pasuri të luajtshme apo paluajtshme në të njëjtin rreth apo ka të dhëna zyrtare se nuk banon në pronën e ish-pronarëve;

- të pushojë shqyrtimin pasi ka ndodhur lirimi dhe dorëzimi i pronës pronarit të ligjshëm.

Me kërkesë me shkri... ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave ka të drejtë të nisë verifikim për shkaqe sipas paragrafit 1 të këtij neni për 10-30% të listës së ish-pronarëve, sipas listës për çdo qark.

Verifikimi kryhet brenda 2 (dy) muajve dhe publikohet si raport në faqen zyrtare të Ministrisë dhe Entit Kombëtar të Banesave, në kuadër të transparencës së këtij procesi. Çdo agjenci shtetërore ka detyrimin të vendosë dokumentacion në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja e kërkesës.


Neni 7

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI


SALI BERISHA

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT


SOKOL DILDASHI

DREJTORIA PËRGJËSENTIT
KOMBËTAR BANESAVE
TIRANË

01 NOV. 2012

nr. 4064



100 Vjet Pavarësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRI

URDHËR

Nr. 125, datë 31.10.2012

PËR

MARRJEN E MASAVE LIGJORE NË EKB, PËR ZBATIMIN E AKTIT NORMATIV,
NR.3, DATË 1.8.2012, "PËR LIRIMIN E BANESAVE PRONARËVE TË LIGJSHËM
NGA QYTETARËT E PASTREHË, BANUES NË BANESAT ISH-PRONË E
SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA",

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", ligjit nr.8485, datë 12.5.1999, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Aktit Normativ nr.3, datë 1.8.2012, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar", ligjit nr. 82/2012, datë 13.09.2012, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 1.8.2012, të Këshillit të Ministrave "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar", pasi jam njohur me, kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të Entit Kombëtar të Banesave në vijim referuar dhe si EKB, me qëllim forcimin e kapaciteteve, trajtimin sipas parimit të barazisë, të ligjshmërisë dhe transparencës së shtetasve që ndodhen në të njëjtën situatë ligjore, me qëllim mbrojtjen e pacënuar të interesave publik të Shtetit Shqiptar në gjykime pranë Gjykatës të Drejtave të Njeriut,

URDHËROJ:

1. Miratimin e akteve "Tip", bashkëlidhur Shtojca 1, në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 1.8.2012, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar" me emërtimin: "a)

Njoftim/konfirmim, b) kërkesë drejtuar gjykatës për lëshim urdhëri dhe c) procesverbal i përbashkët, dokumente pune të EKB, sipas përmbajtjes bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhëri.

2. Miratimin e kërkesës për njoftim tip të pronarëve Shtojca 2. Ftohen pronarët e pasurive të paluajtshme pronat e të cilave janë ende të zëna dhe pas datës 1 nëntor 2012, subjekte të Aktit Normativ nr.3, datë 1.8.2012, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar", të aplikojnë në EKB drejtoritë respektive sipas modelit "Shtojca 2", kërkesë për njoftim bashkëlidhur. Në faqen zyrtare të EKB publikohet ky dokument tip .

3. EKB-ja, në çdo rast të vihet në lëvizje në ushtrim të përgjegjësive në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 1.8.2012, "Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar", vetëm kur depozitohet pranë saj, (drejtorisë qendrore, drejtorisë apo zyrës respektive sipas juridiksionit të caktuar në urdhërin Delegim Kompetencash), kërkesa për njoftim me shkrim, e nënshkruar nga pronari ose një nga bashkëpronarët e pronës.

Kërkesës për njoftim në kuptim të kësaj pike duhet ti bashkëlidhet një fotokopje e kartës së identitetit të personit pronarit/bashkëpronarit ose personit të ngarkuar me prokurë dhe të shoqërohet me 1 (një) kopje të njësuar, (vërtetim njësia me origjinalin) nga noteri, të dokumentit të pronësisë së objektit të lëshuar nga ZRPP me gjithë kartelë të pronës, dhe në përmbajtje të saj, ka të dhëna të sakta, të paktën (emër, mbiemër) për familjen/personin e pastrehë/et që vijon/vijojnë të mbajë/mbajnë të zënë pronën. Asnjë strukturë e EKB-së, drejtori qendrore, drejtori rajonale apo degë rajonale nuk mund të shtojë gjatë ushtrimit të detyrës kërkesa shtesë të tilla si kopje e freskët e certifikatës/vërtetimit të pronësisë pasi EKB-ja, nuk gëzon asnjë tagër për të diskutuar çështje të pronësisë së pronarit të ligjshëm dhe gjithashtu vepron me mirëbesim sipas atit normativ me fuqinë e ligjit. Në rast deklarimi të dhënash të rreme, subjekt i ndëshkimit sipas ligjit, do të jenë autori i tyre/kërkuesi që ka nënshkruar kërkesën.

4. Ngarkohet drejtori : Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave dhe e gjithë struktura e Entit Kombëtar të Banesave për zbatimin e këtij urdhëri. Shkelja e këtij urdhëri apo refuzimi për moszbatim të tij nga punonjës të EKB-së, përbën shkak të mjaftueshëm për zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë sot më datë 30 tetor 2012 dhe ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave për komunikimin e urdhërit gjithë strukturës së EKB-së.

MINISTRI

SOKOL DELDASHI



kredi dhe/ose strehim sipas dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim që jeta e tyre të mos enohet dhe vihet në rrezik;

- kryfzohet në dërgimin e të kësës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit gjatë periudhës së ftohtë të dimrit;
- jetë prezent në fazën e zbatimit të urdhërit të ekzekutimit dhe të monitorojë mbarevajtjen e procesit;
- sigurojë që ekzekutimi i urdhërit ekzekutiv të mos realizohet gjatë natës,
- sigurojë që sendet, pajisjet dhe mobiljet e familjes së nxjerrë me forcë, të mos dëmtohen;
- sigurojë që shpenzimet e transportit të familjeve të nxjerra me force, të përballohen nga pronari.

Në rastin kur në përbërje të familjes ka persona të moshuar mbi 70 vjeç, fëmijë deri në moshën 15 vjeç, grua shtatzënë apo persona të sëmurë, dhe kur kushtet e banimit janë jashtë standardeve për një jetesë të përshtatshme, Enti Kombëtar i Banesave të bashkëpunojë menjëherë me strukturat përkatëse vendore, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizimit dhe Ministrinë Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për të siguruar strehimin e tyre në banesa me qira.

Në rastin kur nuk disponohen banesa sociale me qira, deri në sigurimin e tyre, familja ndihmohet me bonus strehimi.

3/2. Në zbatim të nenit 4, të Aktit Normativ, Enti Kombëtar i Banesave t'i kërkojë urgjentisht këshillave të njësive të qeverisjes vendore, vënien në dispozicion të banesave sociale me qira për qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë.

Gjithashtu, t'i kërkohet këshillave të njësive përkatëse të rezervojnë apartamente sociale me qira, të ndërtuara me kredinë e Bankës për Zhvillim të Keshillit të Evropës, për strehimin e përkohshëm të rasteve emergjente.

Verifikimi i rasteve emergjente të bëhet nga EKB, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në bashki dhe komuna.

3/3. Enti Kombëtar i Banesave, për rastet emergjente të familjeve banuese në ish pronë, të marrë masa për sigurimin e strehimit të përkohshëm të tyre nga kontigjenti i ndërtimeve të apartamenteve që siguron me fondet e veta.

4. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EGlantina Gjermeni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN DHE TURIZMIT
MINISTRI

URDHËR

NR. 34, DATË 23/11 2013

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 125, DATË 31.10.2012 "PËR MARRJEN E MASAVE LIGJORE NË EKB, PËR ZBATIMIN E AKTIT NORMATIV NR.3, DATË 01.08.2012, "PËR LIRIMIN E BANESAVE PRONARËVE TË LIGJSHËM NGA QYTETARËT E PASTREHË, BANUES NË BANESAT ISH-PRONË E SUBJEKTEVE TË SHPRONËSUARA"

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Aktit Normativ nr. 3, datë 01.08.2012, "Për lirimimin e banesave pronareve te ligjshem nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronesuara", i miratuar me ligjin nr.82/2012 date 13.09.2012;

- nisur nga problematika e evidentuar gjatë zbatimit të Aktit Normativ nr. 3, datë 01.08.2012,
- nga fakti që nxjerrja e urdhërit të ekzekutimit nga Enti Kombëtar i Banesave, bëhet vetëm duke u bazuar në deklarinimin e pronarit, ku pasaktësitë në deklarime kanë sjellë pasoja të rënda për familjen qiramarrëse,
- duke konsideruar Komentin nr. 7 të Komitetit të të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, mbi nxjerrjet me forcë nga banesa,

URDHEROJ:

Në urdhërin nr. 125, datë 31.10.2012, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të fjalisë së parë, të paragrafit të dytë, të pikës 3, të shtohet shprehja: "të verifikuar nga strukturat përkatëse të njësisë vendore".
2. Pas pikës 3, shtohen pikat 3/1, 3/2 dhe 3/3, me këtë përmbajtje:
 - 3/1. Enti Kombëtar i Banesave, përpara dërgimit të kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, duhet të:
 - verifikojë, kontrollojë dhe të sigurohet që familjet banuese në ish pronë, të jenë sistemuar

me kredi dhe/ose strehim sipas dispozitave ligjore në fuqi, me qëllim që jeta e tyre të mos cënohet dhe vihet në rrezik;

- kufizohet në dërgimin e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit gjatë periudhës së ftohtë të dimrit;
- jetë prezent në fazën e zbatimit të urdhërit të ekzekutimit dhe të monitorojë mbarëvajtjen e procesit;
- sigurojë që ekzekutimi i urdhërit ekzekutiv të mos realizohet gjatë natës,
- sigurojë që sendet, pajisjet dhe mobiljet e familjes së nxjerrë me forcë, të mos dëmtohen;
- sigurojë që shpenzimet e transportit të familjeve të nxjerra me force, të përballohen nga pronari.

Në rastin kur në përbërje të familjes ka persona të moshuar mbi 70 vjeç, fëmijë deri në moshën 15 vjeç, grua shtatzënë apo persona të sëmurë, dhe kur kushtet e banimit janë jashtë standardeve për një jetesë të përshtatshme, Enti Kombëtar i Banesave të bashkëpunojë menjëherë me strukturat përkatëse vendore, Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Ministrinë Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për të siguruar strehimin e tyre në banesa me qira.

Në rastin kur nuk disponohen banesa sociale me qira, deri në sigurimin e tyre, familja ndihmohet me bonus strehimi.

3/2. Në zbatim të nenit 4, të Aktit Normativ, Enti Kombëtar i Banesave t'i kërkojë urgjentisht këshillave të njëjësive të qeverisjes vendore, vënien në dispozicion të banesave sociale me qira për qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë.

Gjithashtu, t'i kërkohet këshillave të njëjësive përkatëse të rezervojnë apartamente sociale me qira, të ndërtuara me kredinë e Bankës për Zhvillim të Keshillit të Evropës, për strehimin e përkohshëm të rasteve emergjente.

Verifikimi i rasteve emergjente të bëhet nga EKB, në bashkëpunim me strukturat përkatëse në bashki dhe komuna.

3/3. Enti Kombëtar i Banesave, për rastet emergjente të familjeve banuese në ish pronë, të marrë masa për sigurimin e strehimit të përkohshëm të tyre nga kontigjenti i ndërtimeve të apartamenteve që siguron me fondet e veta.

4. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

EGGLANTINA GJERMENI

